



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 194, Datë 13.07.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË
“GERTI” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e” dhe 13 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2015/1 prot., datë 10.07.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *“Mbi kërkesën e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”*,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GERTI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 990 prot., datë 26.03.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 9, pika 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; pika 1.2, gërmat “a” “c” dhe “d”; pika 1.3, gërma “a”.
- Rezulton se shoqëria duhet të plotësojë këtë aplikim dhe me sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: dëshminë e penalitetit për administratorin tjetër të saj.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”**: informacion mbi sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë për 5 vitet e ardhme të ushtrimit të aktivitetit, përlllogaritjen për vlerën që nevojitet për të garantuar ushtrimin e veprimtarisë për të paktën 1 (një) muaj dhe mbështetjen financiare.

- **gërma “c”**: Planin e Biznesit për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore dhe rregullatore për licencim do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE.
- Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet procedurale për fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë)-vjeçar.
2. Shoqëria “GERTI” sh.p.k., të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe sqarimet shtesë të kërkuara gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “GERTI” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI